

V E N D I M

PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me date 30. 01. 1996, une Gjygtarja e Gjykates se rrethit Tirane M. Dedi, pasi shqyrtova materialin a paraqitur nga zonja Hana Cela, shtetase shqiptar madhore, dhe e afte per te kryer veprime juridike, per rregjistrimin si person juridik te Shoqerise "CELA" sh.p.k. Elbasan, me seli ne qytetin e Elbasanit ne lagjen "5 Maj" Pll.710/4.

K O N S T A T O V A

Se kerkuesi kerkon te rregjistroje si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "CELA" SH.P.K. me ortak e administrator te vetem zonjen Hana Cela, me seli ne qytetin e Elbasanit, Lagja "5 Maj" Pll.710/4, me kohezgjatje deri ne vitin 2020, me kapital 100.000 leke dhe me objekt veprimtarie ne fushen e eksport-import te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, shitje me shumic e pakice.

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Ne baze te ligjit 7638, date 19-11-92 dhe ligjit 7667, date 28-1-93 per rregjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te:

V E N D O S A

Rregjistrimin si person Juridik te Shoqerise tregtare "CELA" sh.p.k. - Elbasan, me ortak te vetem zonjen Hana Cela per te ushtruar veprimtari tregtare ne fushen e:

- eksport, import te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, shitje me shumic e pakice.

si Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me ortak te vetem zonjen Hana Cela me kohezgjatje deri me 31.12.2020, me administrator te vetem zonjen Hana Cela me seli ne qytetin Elbasanit. Kunder ketij Vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYOTARJA
MARJANA DEDI



V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 16.03.2001 une gjyqtar i Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit Hana Çela e bija e Ismailit, lindur me 1957 ne qytetin e Elbasanit dhe banues ne qytetin e Elbasanit, lagjia "5 Maj", e cila kerkoj depozitimin e Vendimit te Ortakut te Vetem nr.1 date 09.02.2001 te shoqerise "Çela" sh.p.k.

K O N S T A T O V A:

Se me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr.13585 date 28.01.1996 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria "Çela" sh.p.k, me ortak dhe administrator te vetem zj Hana Çela me seli ne lagjen "5 Maj" te qytetit te Elbasanit, pallati 710/4, me kapital themelues 100.000 leke.

Me Vendimin e Ortakut te vetem nr.1 date 09.shkurt.2001 eshte vendosur:

1. Te ndryshoje nenin te Statutit te Shoqerise duke ndryshuar emerimin e shoqerise nga Shoqeria "Çela" sh.p.k ne shoqeria "Çela P" sh.p.k.

2. Te ndryshoje nenin nr.1 te Statutit te shoqerise mbi objektin e veprimtarise se shoqerise "Çela" sh.p.k. si vijon:

"Import-Eksport. Tregtim me shumice dhe me pakice te te gjitha mallrave industriale, ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar. Transport i mallrave dhe i udhetareve. Tregtim te materialeve ndertimore, pleherave kimike, paisje elektrike dhe elektronike, paisje elektroshtepijake, paisje dentare, konfeksioneve. Punime duroalumini, druri dhe hekuri dhe tregtim materialesh duroalumini, hekuri dhe druri. Grumbullimi dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore. Tregtim me pakice te karburanteve, vajrave lubrifikante, grasove, pjeseve te kembimit per makineri e paisje. Krijimi i agjensive te udhetimit dhe turistike".

3. Te transferoje te gjitha kuotat ne masen 100% qe zoteron ne shoqeri bazuar ne nenin nr.5 te Statutit, nepermjet dhurimit te tyre ortakut te vetem te ri z. Petrit Çela dhe caktimin e tij si administrator te shoqerise me emer te ndryshuar "Çela P" sh.p.k.

4. Ky vendim i bashkengjitet Statutit te shoqerise "Çela" sh.p.k ndryshuar emerit ne "Çela P" sh.p.k.

4. Ky vendim te depozitohet ne rregjistrin tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Ne keto kushte kerkuesi kerkon depozitimin e vendimit prane rregjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667 date 28.1.1993 "Per rregjistrin tregtar"

V E N D O S A:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne rregjistrin tregtar te vendimit te Ortakut te Vetem nr.1 date 09 shkurt 2001 te shoqerise "Çela" sh.p.k.

Te behen shenimet perkatese ne Rregjistrin Tregtar

GJYQTAR
Dhila Cafa
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 13585 / 2 vendimit

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Sot me date 16-09-05, une, gjyqtar i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit **Petrit Çela** i biri i Ymerit, lindur me 16.09.1960 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, per depozitim ne rregjistrin tregtar te vendimit nr.1 date 03.05.2005 te ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise "CELA P."sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

K O N S T A T O V A S E:

Me vendimin nr. 13585 date 28.01.1996 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "Çela" sh.p.k, me ortak dhe administrator te vetem Zj.Hana Çela, me kapital 100.000 leke me seli ne Elbasan. Me vendimin e ortakut te vetem nr.1 date 09.02.2001 te regjistruar ne Rregjistrin Tregtar me nr.13585 vendimi date 16.03.2001 eshte vendosur: 1-Nderrimi i emerit te shoqerise nga shoqeria "Cela" ne shoqeria " Çela P." Sh.p.k; 2-Ndryshimi i objektit te veprimtarise se shoqerise dhe 3-transferimi i 100% te kuotave nga zj.Hana Çela tek ortaku dhe administratori i ri i shoqerise z.Petrit Çela. Me vendimin nr.1 te dates 03.05.2005 te Ortakut te vetem eshte vendosur: 1.Te shtoje kapitalin e shoqerise nga fitimet e pa perdorura gjendje ne llogarite e ndryshme te paraqitura ne bilanc. 2. Per vleresimin e kapitalit te caktoje ekspert kontabel te autorizuar z.Eduart Kila. 3.Rregjistrimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar. Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R E S Y E :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar"

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.
Depozitimim ne rregjistrin tregtar te vendimit nr.1 date 03.05.2005 per caktimin e ekspertit kontabel te autorizuar z.Eduart Kila..
Te behen shenimet perkatese ne Rregjistrin Tregtar .

GJYQTAR
Ariane Cepo



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 13585/3 vendimit

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 09.09.05, une, gjyqtar i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesit **Petrit Çela** i biri i Ymerit, lindur me 16.09.1960 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, per depozitim ne rregjistrin tregtar te vendimit nr.1 date 03.05.2005 dhe vendimit nr.2 date 25.06.2005 te ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise " CELA P."sh.p.k. dhe dokumentave te tjera te paraqitura prej tij,

K O N S T A T O V A S E:

Me vendimin nr. 13585 date 28.01.1996 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "Çela" sh.p.k , me ortak dhe administrator te vetem Zj.Hana Çela, me kapital 100.000 leke me seli ne Elbasan.

Me vendimin e ortakut te vetem nr.1 date 09.02.2001 te regjistruar ne Rregjistrin Tregtar me nr.13585 vendimi date 16.03.2001 eshte vendosur: 1-Nderrimi i emerit te shoqerise nga shoqeria "Cela" ne shoqeria " Çela P." Sh.p.k; 2-Ndryshimi i objektit te veprimtarise se shoqerise dhe 3-transferimi i 100% te kuotave nga zj.Hana Çela tek ortaku dhe administratori i ri i shoqerise z.Petrit Çela.

Me vendimin nr.1 te dates 03.05.2005 te Ortakut te vetem eshte vendosur: 1.Te shtoje kapitalin e shoqerise nga fitimet e pa perdorura gjendje ne llogarite e ndryshme te paraqitura ne bilanc. 2. Per vleresimin e kapitalit te caktoje ekspert kontabel te autorizuar z.Eduart Kila. 3.Rregjistrimin e ketij vendimi ne rregjistrin tregtar.

Me vendimin nr.2 te dates 25.06.2005 te ortakut te vetem te shoqerise "Çela P. " sh.p.k eshte vendosur:

1-Te miratoje raportin e ekspertit kontabel z.Eduart Kila lidhur me vleresimin e kapitalit te shoqerise.

2-kapitali i shoqerise te vleresohet per 2.406.000 leke sa raportuar nga eksperti. Numri i pjeseve te kapitalit te jete per 2.406 njesi me vlere nominale per cdo njesi per leke 1.000

3.Te behet depozitimi i ketij vendimi ne rregjistrin Tregtar per te bere ndryshimet e nevojshme ligjore.

Ne keto kushte kerkoj nga Gjykata miratimin dhe depozitimn e ketij vendimi prane regjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE :


Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar"

V E N D O S A :

Pranimin e kerkeses.

Depozitimn ne regjistrin tregtar te vendimit nr. 2, date 25.06.2005 per vleresimin e kapitalit te shoqerise " Cela P. " sh.p.k.

Te behen shenimet perkatese ne Rregjistrin Tregtar .

GJYQTAR


13585

- 1
- 2- a) "Cela" sh.p.k.
 b) L "5 Maji", P 710/4, Elbasan.
 c) eksport, import i mallave te + iud, ushqimore, shije ne shumice dhe pakice.
 £) 100 000 lile.
 Huma Cela.
- 3- Aktua: Huma Cela, del 1957, karves ne L "5 Maji", P 7104/4, Elbasan.
- 4- 10 vjet
 vete 1fl + 1
 st 6fl
- 5- 19.01.1996
 28.01.1996

[Signature]

Loketimi 1964 / 3620
 Mandati 239350. B.K.T. Elbasan.
 dt 17-1-96

STATUS

I SHOQERISE "CELA"-SH.P.K.

Shoqeria tregtare "CELA" SH.P.K.Elbasan themelohet lirisht nga zoti:

Hana Cela, e bija e Ismailit,d.l.1957 lindur e banuese ne Elbasan.lagja"5 Maj"Pll.7107/4.

Shoqeria ne formen e shoqeris me pergjegjisi te kufizuar do te zhvilloje aktivitetin e saj ne baze te ligjeve Nr.7512 date 10.08.1991 Nr.7638 date 19.11.1992 Nr.7667 date 28.01.1993 Shoqeria pasi te ketë bere rregjistrimin ne Gjykatene rrethit Tirane do te veproje si person juridik,me te drejta te plota me mjetet financiare e materiale te disponueshme e te deklaruarat perpara autoriteteve kompetente shqiptare.

NENI 1

Shoqeria "CELA" SH.P.K. Elbasan ka per objekt te veprimtarise se saj :

- eksport, import te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, shitje me shumic e pakice.

NENI 2

Shoqeria mundet te kryeje te gjitha operacionet tregtare .Levizjet e vlerave te rrjedhura nga pasurit e tundeshme e te patundeshme .Shoqeria ka seline ne qytetin e Elbasanit, dhe ka te drejte te hape filiale ne te gjithë territorin e Shqiperis dhe jashte shtetit.

NENI 3

Kohezgjitja e shoqeris eshte fiksuar deri me 31.12.2020 dhe mundet te zgjatet nga asambleja e ortakeve sipas afatit te ligjit.

NENI 4

Kapitali social i shoqeris eshte fiksuar ne 100.000 (njqindmije) leke i ndare ne 100 (njqind) kuota me nga 1000(njemije) leke secila kuote.

Ortaku i vetem Hana Cela mban 100 kuota.

NENI 5

Transferimi i kuotve duhet te realizohet sipas normave te parashikuara nga nenet 45,46,47 dhe 49 te ligjit 7638 date 19.11.1992 "PER SHOQERIT TREGTARE".

NENI 6

Mbledhjet e asambleve thirren nga keshilli i administrimit ose nga eksperti kontabel i autorizuar nga nje ose me shume ortake qe perfaqsojne te pakten 10% te kapitalit social .

NENI 7

Thirrja e ortakeve behet me shkrim me leter te rekomanduara qe duhet te arrije tek ortaket te pakten 30 dite perpara mbledhjes. Letra e thirrjes duhet te permbaje vendin,diten e oren e mbledhjes si dhe rendin e dites, gjithashtu duhet te permbaje vendin ,diten e oren e mbledhjes se dyte ne raste se ne mbledhjen e pare nuk eshte e mundur te arrihet shumica e nevojshme .

NENI 8

Asambleja drejtohet nga kryetari i keshillit te administrimit ose nga nje ortak i zgjedhur nga asambleja i ndihmuar nga nje sekretar i emruar.

NENI 9

Cdo ortak ka aq vota sa jane edhe kuotat e kapitalit qe zoteron . Cdo ortak mundet te perfaqsohet ne asamble nga nje ortak tjeter ose nga nje person i trete i besuar ,pervec administratoreve.

NENI 10

Ndryshimet ne statut aprovohen me ato vota qe perfaqsojne te pakten 3/4 e kapitalit social. Per vendimet e tjera te asamblese jane te nevojshme votat e nje ose me shume ortakeve qe perfaqsojne te pakten 70% te kapitalit social ne thirrjen e pare dhe shumicen e votave te ortakeve te pranishem ne thirrjen e dyte. Per konsultimet me shkrim kerkohet mendimi i i te gjithë ortakeve. Ne raste te mungeses se pergjigjes brenda dites se 20 nga data e marrjes se kerkeses se shkruar konsiderohet si i shprehur mendimi i favorshem. Vlejne ne kete rast dhe normat e kerkeses se dyte sic parashikohet nga neni Nr.59 i ligjit "PER SHOQERITE TREGTARE".

NENI 11

Ne rast ndryshimesh te ligjit qe kerkojne nje pershtatje te statutit keshilli i administrimit do te percaktoje pa vones ne thirrjen e asamblese se ortakeve.

NENI 12

Vendimet e asamblese aprovohen me modalitetet e herepashershme te peraktuara nga kryetari i asamblese. Vendimet e asamblese te marra konform ligjit e statutit lidhin te gjithë ortaket edhe ne qofte se nuk se nuk jane present ose nuk jane dakord. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak te shtoje pjesen e tij te kapitalit social.

NENI 13

Shoqeria administrohet nga keshilli i administrimit anetaret e te cilit mundet te mos jene ortake. Numri i tyre percaktohet herepasehere nga asambleja. Ne rast te emertimit te nje administratori te vetem ai do te marrë persiper kompetencat totale te keshillit te administrimit dhe te kryetarit te tij. Administratorët rrine ne detyre per te kryer detyra sociale dhe mundet te shkakrohen ne cdo kohe. Keshilli i administrimit emerohet ne aktin e themelimit. Ndermjet anetareve te tij keshilli i administrimit zgjedh kryetarin e tij.

NENI 14

Keshilli i administrimit ka te gjitha kompetencat per administrimin e shoqeris ne kufijt e objektit social dhe ato qe ligji dhe statuti i rezervojne asamblese. Keshilli i administrimit mundet ndermjet te tjerave te bleje te shes, te shkembeje pasurit e tundeshme e te patundeshme, ti jape shoqerive te tjera te themeluara ose qe jane duke u themeluar, te marre

persiper per qellime sociale, te marre kredi duke i garantuar me ipotek ,te jape lejen per fshirjen hipotekare mbi pasurit e shoqeris ,te kryeje marrveshje te leverdiseshme ,te autorizoj e te kryeje cdo operacion ne zyrtat publike e private e ne vecanti ne banka. Keshilli i administrimit mundet ti delegeje nje anetari te tij detyrat e nje administratori te zakonshem per nje sektor specifik (Keshilltar i deleguar) ose per te gjithë aktivitetin (administrator i deleguar).Kufijt e shpenzimeve dhe te kompetencave do te vendosen nga keshilli i administrimit .Keshilli i administrimit ka te drejten te emroj nje drejtor dhe prokurator per akte te percaktuara e kategori aktesh.

NENI 15

Asambleja e ortakeve ka perfaqsim ligjor te shoqeris perballe te treteve ne gjykim dhe te drejten qe te ndermarre masat e nevojshme sipas rastit dhe te bej kerkesa gjyqsore e veprime te tjera administrative per cdo shkalle gjykimi,revokimi e kasacioni si dhe te emerjoj per kete avokat e prokurator per mosmarrveshjet e paraqitura. Keshillit te administrimit i takon kthimi i shpenzimeve te kryera ne sherbim te detyrave te tij. Asambleja mundet te caktojë nje shperblim vjetor.

NENI 16

Keshilli i administrimit thirret nga kryetari me iniciativen e tij dhe me kerkesen e nje anetari te tij. Per vlefshmerin e vendimeve te keshillit te administrimit kerkohet prania e shumices se administratorëve. Vendimet merren me shumic absolute, ne rast barazimit te votave mbizotron vota e kryetarit .

NENI 17

Asambleja mundet te emerjoj nje keshill administrimi kur te pakten jane dy ortak .Ne rast te nje ortaku te vetem do te kete nje administrator te vetem.

NENI 18

Eshte kompetence e asamblese se ortakeve :

- a) Aprovimi i bilancit vjetor.
- b) Emerimi i nje ose me shume eksperteve kontabel te autorizuar .
- c) Aprovimi i nje rregulloreje te brendeshme dhe i struktures organizative .
- d) Emerimi i keshillit te administrimit.
- e) Aprovimi i ndyshimeve ne statut.

- f) Kufizimi i kompetencave te administratoreve dhe autorizimi i operacioneve qe kalojne kufijte te permendur,
- g) Te vendose likuidimin e shoqerise .
- h) Emerimi i likuidatoreve.
- i) Aprovimi i llogarive trjedhese.

NENI 19

Ushtrimet sociale mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Keshilli i administrimit pergatit bilançin dhe dokumentat relative brenda 31 marsit te cdo viti ne menyre te tille qe te lejoj aprovimin nga ana e asamblese se ortakeve brenda dates 30 prill . Per te lejuar detyrimet e paparashikuara nga ligji Nr.7661 date 19.01.1993 per kontabilitetin. Bilanci ,llogarit e fitimeve e te humbjeve si dhe raporti mbi shoqerim duhet te kopjohen me korrektesi e me respektimin e ligjeve ne fuqi.

NENI 20

Fitimet neto pasi hiqet nje shume 10 me e vogel se 5% e rezerves ligjore te domosdoshme i atribohen kapitalit pervec rasti kur asambleja vendos formimin e rezervave speciale ose shperndarjen e shumes ortakeve.

NENI 21

Pagimi i perqindjeve (dividenteve) kryhet ne menyrat e afatet e percaktuara nga keshilli i administrimit dhe sidoqofte brenda 2 muajve nga dita e vendimit te asamblese.

NENI 22

Asambleja e ortakeve mundet ose nese e kerkon ligji te emeruje nje ose me shume ekspert kontabel te autorizuar per nje perimthe prej 6 vjetesh fiskal,ne kufijt e parashikuar nga nenet 168 e 169 te ligjit "PER SHOQERIT TREGTARE" te cilet do te veprojne sipas afateve te ligjit te mesiperit.

NENI 23

Pervec rasti te likuidimit ,duke vendosur ne cfardo kohe ose per cfardo motivi per shkrirjen e shoqeris ,asambleja do te emeruj nje ose me shume likuidues duke i percaktuar kompetencat e kompensimet .

NENI 24

Te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese qe duhet te aprovoj llogarit sociale kete llogari do te jene ne dispozicion te ortakeve ne seline e shoqerise. Keshilli i administrimit do te peraktoje rregullat operative per ti bere te mundur ortakeve konsultimin e librave e llogarive sociale te pakten 2 here ne vite.

NENI 25

Cdo mosmarrveshje qe do te lindre ndermjet ortakeve dhe administratoreve do ti ngarkohen apo jepen nje keshilli arbitrues i perbere nga 3 anetare nga te cilet 2 te emeruar nga gjykata e rrethit Tirane. Arbitrat do te gjykojne perfundimisht konfliktin e hapur shoqeris .

NENI 26

Persa nuk eshte e parashikuar nga statuti i tanishem do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

Elbasan, me 28.08.1995

SHOQERIA "CELA" S.H.P.K

HANA CELA



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT ELBASAN
NOTERIA**

Nr. 231/147

Elbasan, me 15.1.....1996

VERTETIM

Une noteria Elida Magani ,vertetoj se perpara meje eshte paraqitur personalisht zonja Hana Cela e cila pasi u identifikua nga ana ime ,deklaroi se eshte dakord me permbajtjen e aktit te mesiperm dhe se nenshkrimi eshte hedhur prej saj me vullnet te lire e pa asnje hezitim ne pranine time.

**NOTERIA
/ ELIDA MAGANI /**

**AKT THEMELIMI
E SHOQERISE "CELA"
SH.P.K. - ELBASAN**

Shoqeria "CELA" sh.p.k. themelohet lirisht me inisiativen e zonjes:
Hana Cela, e bija e Ismailit, dl. 1957 lindur e banuese ne Elbasan, lagja "5 Maj" Pll.7107/4.
Shoqeria "CELA" ne formen e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do ta zhvilloje
aktivitetin e saj ne baze te ligjeve numer 7512 date 10.08.1991, numer 7638 date
19.11.1992, numer 7667 date 28.01.1993. Shoqeria pasi te kete bere rregjistrimin ne
Gjykatën e rrethit Tirane, do te veproje si person juridik, me te drejta te plota, me mjetet
financiare e materiale te disponueshme e te deklaruar perpara autoriteteve kompetente
shqiptare.

Objekti i veprimtarise tregtare te shoqetise "CELA" sh.p.k. do te jete :

**- eksport, import te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore,
shitje me shumic e pakice.**

Kontrata baze ne te cilin shoqeria do te mbeshtese veprimtarise e saj eshte Statuti ne
te cilin peraktohet forma e organizimit, drejtimit, administrimit, te Shoqerise, afatet,
qellimet, kapitali i saj te cilet jane te detyrueshme si per themeluesit e kesaj shoqerore
ashtu edhe per raportet e ortakerise qe mund te pasojne ne jetegjatesine e kesaj
shoqerie. Akti i themelimit bashkangjitet me Statutin i cili ploteson qellimet e ketij akti.

Kapitali social i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke shqiptare .

Kapitali social i shoqerise eshte i ndare ne 100 (njqind) kuota me nga 1.000 (njemije)
leke seicila kuote.

Ortaku i vetem HANA CELA zoteron 100 kuota.

Administratori i vetem i shoqerise "CELA" sh.p.k. eshte zonja Hana Cela. Selia
e shoqerise "CELA" sh.p.k.- Elbasan, do te jete ne qytetin e Elbasanit ne lagjen
"5 Maj" Pll.710/4.

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne vitin 2020.

SHOQERIA "CELA" SH.P.K. -ELBASAN

HANA CELA





REPUBLIKA E SHQIPERISE

ZYRA E NOTERISE

Nr. 231/171

Elbasan, me 15.1.1976

VERTETIM

Une noterja Elida Magani vertetoi se perpara meje eshte paraqitur shtetesja shqiptare Hana Cela e cila pasi u identifikua prej meje me ane te leternjoffimit dhe rezultoi madhore dhe e afte per te kryer veprime juridike, deklaroi se eshte dakort me permbatjen e aktit te mesiperm dhe e nenshkroi ate pa asnje hezitim ne pranine time si notere.

NOTERE
ELIDA MAGANI

13585/2

S Ariano Celo
13 KORRIK 13 02 2005
[Signature]

KERKESE

KERKUESI : z. **Petrit Çela** i biri i Ymerit, lindur me 16.09.1960 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, madhor me zotesi te plote per te vepruar me cilesine e, ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise "ÇELA P" sh.p.k.

Objekti : Depozitimim ne regjistrin tregtar te vendimit nr.1 te ortakut te vetem te shoqerise "ÇELA P" sh.p.k.

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Me vendimin nr. 13585 date 28.01.1996 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "Çela" sh.p.k , me ortak dhe administrator te vetem Zj.Hana Çela me kapital 100.000 leke me seli ne Elbasan.

Me vendimin e ortakut te vetem nr.1 date 09.02.2001 te rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar me nr.13585 vendimi date 16.03.2001 eshte vendosur: 1-Nderrimi i emerit te shoqerise nga shoqeria "Cela" ne shoqeria "Çela P." Sh.p.k; 2-Ndryshimi i objektit te veprimtarise se shoqerise dhe 3-transferimi i 100% te kuotave nga zj.Hana Çela tek ortaku dhe administratori i ri i shoqerise z.Petrit Çela.

Me vendimin nr.1 te dates 03.05.2005 te Ortakut te vetem eshte vendosur: 1.Te shtoje kapitalin e shoqerise nga fitimet e pa perdorura gjendje ne llogarite e ndryshme te paraqitura ne bilanc. 2. Per vleresimin e kapitalit te caktoje ekspert kontabel te autorizuar z.Eduart Kila. 3.Rregjistrimin e ketij vendimi ne regjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

[Large handwritten signature: Eduart Kila]

ORTAKU

Petrit Çela

[Signature of Petrit Çela]

DHOMA E NOTERISE Elbasan

NR. 4870 REP.




TAKSA E PULLES
D LIKUJDDUA

VERTETIM

Sot me date 01/07 / 2005, para meje noterit publik Majlinda Lato me seli ne Elbasan, u paraqit personalisht z. Petrit Çela, i biri i Ymerit ,dtl. 1960, lindur ne Elbasan e banues ne Elbasan, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me cilesine ortakut te vetem dhe administratorit te shoqerise "Çela P" sh.p.k i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperme ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan ate para meje. Une noterit e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI PUBLIK



NOTERJA
MAJLINDA LATO

**“CELA P.”
SHOQERI TREGETARE
NE PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR
ELBASAN**

Elbasan 03.05.2005

**V E N D I M
Nr 1 Dt.03.05.2005**

Sot ne mbledhjen e Dt.3.05.2005 une ortaku I vetem Petrit Cela e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar te emertuar : “CELA P.” SH.P.K me seli ne Elbasan mbasi mora ne analize aktivitetin ekonomik te shoqerise per vitin 2004,percaktova treguesit financiar te se ardhmes se shoqerise , ne perputhje me statutin dhe ligjet ne fuqi dhe

V E N D O S A

- 1-Te shtojme kapitalin e shoqerise nga fitimet e paperdorura gjendje ne llogarite e ndryshme te paraqitura ne bilanc.
- 2-Per vleresimin e kapitalit te caktojme ekspert kontabel te autorizuar Z.Eduart Kila.
- 3-Mbas kryerjes se veprimeve perkatese te depozitohen vendimet e marra ne regjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane per te bere ndryshimet e nevojshme.

O R T A K U I V E T E M

P E T R I T C E L A


P E T R I T C E L A



REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE ELBASAN
Nr. _4968_Rep

Elbasan me 01.07.2005

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 01.07.2005 ne Elbasan ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan, para meje noteres Majlinda Lato u paraqit personalisht z.Petrit Çela i biri i Ymer, lindur me 16.09.1960 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike i njohur nga une noteria ne baze te ligjit i cili dokumentin e mesiperm e nenshkroi me doren e tij dhe me vullnet te lire ne pranine e noteres.U vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit.

NOTERE
MAJLINDA LATO



3 A Cepo
12 MAR. 2001
11 05. 2001
Hana Çela

13

13585/1

K E R K E S E

K E R K U E S : Hana Çela e bija e Ismailit, lindur me 1957 ne qytetin e Elbasanit dhe banues ne qytetin e Elbasanit, lagjia "5 Maj".

O B J E K T I : Depozitim prane Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane te Vendimit te Ortakut te Vetem te shoqerise "Çela" sh.p.k ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 dhe te ligjit nr.7667 date 28.01.1993.

PERPARA

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Z.Kryetar!

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Çela" sh.p.k me seli ne qytetin e Elbasanit, lagjia "5 Maj", pallati 710/4, eshte e regjistruar si person juridik ne baze te vendimit me nr.13585 date 28.01.1996.-.

Shoqeria "Çela" sh.p.k eshte e regjistruar ne rregjistrin tregtar te shoqerive me nje ortak te vetem dhe me administrator te vetem ortakun e saj Hane Çela.

Me vendimin e ortakut te vetem te shoqerise "Çela" sh.p.k me nr.1 date 09.02.2001 eshte vendosur ndryshimi i emerit te shoqerise nga shoqeria "Çela" sh.p.k ne shoqerine "Çela P" sh.p.k, shtimi i objektit te veprimtarise se shoqerise si dhe dhurimi i 100% te aksioneve z.Petrit Çela i cili behet dhe administrator dhe ortak i vetem i shoqerise me emer te ndryshuar "Çela P".

Per sa me siper kerkoj nga Gjykata depozitim e vendimit te ortakut te vetem nr.1 date 09.02.2001.

Kesaj kerkese i bashkengjitet vendimi i ortakut te vetem nr.1 date 09.02.2001 dhe kontrata e dhurimit te aksioneve me nr.1426 rep., nr.249 kol. date 09.02.2001.

KERKUESI

Hana Çela

Hana Çela

Handwritten notes:
- "D. Veroli" (circled)
- "D. Kertner"
- "Gjykata e Tiranës"
- "13.03.2001"
- "09.02.2001"
- "11.05.2001"

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE ELBASAN
Nr. 1427 Rep

Elbasan me 09.02.2001

TAKSA E PELLE
U LIKUJUA



VERTETIM

Sot me date 09.02.2001 ne Elbasan ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan, para meje noteres Majlinda Lato u paraqit personalisht zj.Hene Çela e bija e Ismailit ,lindur me 20.01.1957 ne Elbasan dhe banuese ne Elbasan madhore dhe e afte per te kryer veprime juridike e njohur nga une noteria ne baze te pasaportes qe me paraqiti me nr.0859903 e cila dokumentin e mesiperm e nenshkroi me doren e tij dhe me vullnet te lire ne pranine e noteres.U vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit.

NOTERE
MAJLINDA LATO



V E N D I M

I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "ÇELA" sh.p.k

Nr.1 date 09.02.2001

Sot me date 09.02.2001 Ortaku i vetem i shoqerise "Çela" sh.p.k me seli ne qytetin e Elbasanit, lagjia "5 Maj", pallati nr.710/4, mbeshtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 dhe ne Statutin e shoqerise,

V E N D O S I :

1. Te ndryshoje nenin te Statutit te Shoqerise duke ndryshuar emerine e shoqerise nga Shoqeria "Çela" sh.p.k ne shoqeria "ÇELA P" sh.p.k.

2. Te ndryshoje nenin nr.1 te Statutit te shoqerise mbi objektin e veprimtarise se shoqerise "Çela" sh.p.k. si vijon:

"Import-Eksport. Tregtim me shumice dhe me pakice te te gjitha mallrave industriale, ushqimore dhe bujqesore qe lejon legjislacioni shqiptar. Transport i mallrave dhe i udhetareve. Tregtim te materialeve ndertimore, pleherave kimike, paisje elektrike dhe elektronike, paisje elektroshtepijake, dhe tregtim te konfeksioneve. Punime duroalumini, druri dhe hekuri dhe tregtim materialesh duroalumini, hekuri dhe druri. Grumbullimi dhe tregtimi i bimeve medicinale dhe eterovajore. Tregtim me pakice te karburanteve, vajrave lubrifikante, te grasove, pjeseve te kembimit per makineri e paisje. Krijimi i agjensive te udhetimit dhe turistike".

3. Te transferoje te gjitha kuotat ne masen 100% qe zoteron ne shoqeri bazuar ne nenin 5 te Statutit, nepermjet dhurimit te tyre ortakut te vetem te ri z. Petrit Çela dhe caktimin e tij si administrator te shoqerise "Çela P" sh.p.k.

Ky vendim i bashkengjitet Statutit te shoqerise "Çela" sh.p.k ndryshuar emeri ne "Çela P" sh.p.k.

4. Ky vendim te depozitohet ne rregjistrin tregtar ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

Ortaku dhe Administratori i vetem

I shoqerise "Çela" sh.p.k

Hana Çela

Hana Çela



REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE ELBASAN

Elbasan me 09.02.2001

Nr. 1925 Rep

TAKSA E PULI
U LIKUJDR



VERTETIM

Sot me date 09.02.2001 ne Elbasan ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan, para meje noteres Majlinda Lato u paraqit personalisht zj.Hana Çela e bija e Ismailit ,lindur me 20.01.1957 ne Elbasan dhe banuese ne Elbasan madhore dhe e afte per te kryer veprime juridike e njohur nga une noteria ne baze te pasaportes qe me paraqiti me nr.0859903 e cila dokumentin e mesiperm e nenshkroi me doren e tij dhe me vullnet te lire ne pranine e noteres.U vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit.

NOTERE
MAJLINDA LATO



REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE ELBASAN

Elbasan 09.02.2001

Nr. 1426 Rep.

Nr. 149 Kol.



KONTRATE DHURIMI

Sot me date 09.02.2001(nente shkurt dymije e nje)ne Elbasan ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan, para meje noteres Majlinda Lato u paraqiten personalisht palet kontraktuese,shtetas shqiptare:-----

Ne cilesine e dhuruesit:

Zj.Hana Çela e bija e Ismalit,lindur me 20.01.1957 ne Elbasan dhe banuese ne Elbasan,me nr.pasaporte 0859903 te leshuar date 04.06.1997.---

Ne cilesine e pranuesit:

Zj.Petrit Çela i biri i Ymerit,lindur me 16.09.1960 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan,me nr.pasaporte 1646504 te leshuar date 30.06.1999,bashkeshorti i dhurueses Hana Çela.---

Qe te dy madhore dhe te afte per te kryer veprime juridike ,shtetas shqiptare,te njohur nga une noteria ne baze te dokumentave identifikues qe me paraqiten te cilet me kerkuan redaktimin e ketij akti si vijon:-----

Dhuruesia Hana Çela eshte ortake e vetme e shoqerise "Çela" sh.p.k dhe eshte e rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Tiranes me nr.13585 vendimi date 28.01.1996 dhe me seli te shoqerise ne qytetin e Elbasanit ne lagjen "5 Maj",pallati 710/4 dhe me nje kapital fillestar 100.000 leke.-----

Dhuruesia Hana Çela deklaroi se te gjitha kuotat qe zoteron ne shoqerine "Çela" sh.p.k ja dhuron pranuesit te dhurimit Petrit Çela pa kundershperblim---

Dhe pranuesi i dhurimit Petrit Çela deklaroi se e pranon dhurimin e kuotave qe i behet nga dhuruesja Hana Çela pa kundershperblim.-----

Qe ne kete moment pronesia mbi shoqerine "Çela" sh.p.k dhe mbi te gjitha kuotat qe dhuruesja zoteron ne kete shoqeri si te pershkruar me siper kalon nga dhuruesia Hana Çela tek pranuesi i dhurimit Petrit Çela e lire nga cdo pengese ligjore e barre ipotekimi,e lire dhe e papenguar qe ne kete moment.-----

Ketij akti i bashkengjitet vendimi i gjykates se Tiranes nr.13585 date 28.01.1996.Ky akt perben nje akt te vetem.-----

Kjo kontrate dhurimi hartohet duke u bazuar ne nenin 761 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.-----

Mbi sa me siper u redaktua ky akt ne kater kopje te njehta origjinale,iu lexua paleve ne kontrate me ze te larte,te cilet pasi me deklaruan se e kane degjuar dhe e kane kuptuar dhe eshte konform vullnetit te tyre te shprehur,me doren e tyre dhe me vullnet te lire e nenshkruan ne pranine time noteres rregullisht.Ne fund u vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit dhe konform tij.

PALET KONTRAKTUESE

DHURUESIA

PRANUESI DHURIMIT

Hana Ismail Cela

Petrit Ymer Çela

 Hana Cela

 Petrit Çela

NOTERE
MAJLINDA LATO





KERKESE

13585

KERKUESI- Hana Cela, e bija e Ismailit, dl. 1957 lindur e banuese ne Elbasan, lagja "5 Maj" Pll.7107/4.

OBJEKTI - Rregjistrimi nga Gjykata e rrethit Tirane, i Shoqerise tregtare "CELA" sh.p.k., si person juridik ne baze te ligjeve numer 7512 date 10.08.1991, nr.7638 date 19.11.1992, numer 7667 date 28.01.1993.

PERPARA

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

*Be' rregjistrimit
akt 31-1-96
Gjykatere
H. Deda
M. Deda*

Shoqeria tregtare "CELA" sh.p.k. - Elbasan, eshte themeluar me inisiativen e pronarit te kesaj shoqerie zonjes Hana Cela me seli ne qytetin e Elbasanit ne lagjen "5 Maj" Pll.710/4. Dhe me objekt te veprimtarise se saj:

- eksport, import te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, shitje me shumic e pakice.

Shoqeria do te mbeshtetet ne aktin baze te saj qe eshte Statu i kesaj Shoqerie qe percakton formen e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar sdhe aktivitetin e saj tregetar privat do ta zhvillojne ne baze te ligjeve numer 7512 date 10.08.1991, numer 7638 date 19.11.1992, numer 7764 date 02.11.1993. Shoqeria pasi te kete bere rregjistrimin ne Gjykatën e rrethit Tirane, do teveproje si person juridik me te drejta te plota sipas disponimit me mjetet financiare e materiale te disponueshme e te deklaruar perpara organeve perkatese.

Vec Statutit Shoqeria do te mbeshtetet edhe ne aktin e themelimit apo kontraten e ortakerise si akte te domosdoshme qe i bashkangjiten kesaj kerkesë.

Shoqeria do te respektoje ligjet ekonomike, financiare, doganore e ne pergjithesi legjislacionin shqiptar e ate nderkombetar.

Ne mbeshtetje te ligjit "PER SHOQERITE TREGETARE" numer 7638 date 19.11.1992, kerkoj nga Gjykata e rrethit Tirane qe te marre ne shqyretim kerkesen me materialet qe i bashkangjis asaj dhe te vendose per rregjistrimin si person juridik te Shoqerise private "CELA" me seli ne qytetin e Elbasanit.

Elbasan, me _____

KERKUESI
/HANA CELA/

H. Cela

13585/3 OBSHTATOR 2005
3 Blerime Mucos
08 08 2005
Mucos

KERKESE

KERKUESI : z. Petrit Çela i biri i Ymerit, lindur me 16.09.1960 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, administrator i shoqerise "Çela P." sh.p.k

Objekti : Depozitimin ne regjistrin tregtar te vendimit nr 2 date 25.06.2005 te ortakut te vetem te shoqerise "Çela P." sh.p.k

PERPARA

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Me vendimin nr. 13585 date 28.01.1996 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "Çela" sh.p.k; me ortak dhe administrator te vetem Zj.Hana Çela, me kapital 100.000 leke me seli ne Elbasan.

Me vendimin e ortakut te vetem nr.1 date 09.02.2001 te regjistruar ne Regjistrin Tregtar me nr.13585 vendimi date 16.03.2001 eshte vendosur: 1-Nderrimi i emerit te shoqerise nga shoqeria "Çela" ne shoqeria "Çela P." Sh.p.k; 2-Ndryshimi i objektit te veprimtarise se shoqerise dhe 3-transferimi i 100% te kuotave nga zj.Hana Çela tek ortaku dhe administratori i ri i shoqerise z.Petrit Çela.

Me vendimin nr.1 te dates 03.05.2005 te Ortakut te vetem eshte vendosur: 1.Te shtoje kapitalin e shoqerise nga fitimet e pa perdorura gjendje ne llogarite e ndryshme te paraqitura ne bilanc. 2. Per vleresimin e kapitalit te caktoje ekspert kontabel te autorizuar z.Eduart Kila. 3.Regjistrimin e ketij vendimi ne regjistrin tregtar.

Me vendimin nr.2 te dates 25.06.2005 te ortakut te vetem te shoqerise "Çela P." sh.p.k eshte vendosur:

1-Te miratoje raportin e ekspertit kontabel z.Eduart Kila lidhur me vleresimin e kapitalit te shoqerise.

2-kapitali i shoqerise te vleresohet per 2.406.000 leke sa raportuar nga eksperti. Numri i pjeseve te kapitalit te jete per 2.406 njesi me vlere nominale per cdo njesi per leke 1.000

3.Te behet depozitimi i ketij vendimi ne regjistrin Tregtar per te bere ndryshimet e nevojshme ligjore.

Ne keto kushte kerkoj nga Gjykata miratimin dhe depozitimin e ketyre vendimeve prane regjistrin tregtar.

KERKUESI

Petrit Çela

Ortak dhe administrator i vetem

i shoqerise "Çela P." sh.p.k



REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE ELBASAN
NR. 5407 REP.

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Elbasan, sot me date 18.07.2005, para meje noterit publik Majlinda Lato, me seli ne Elbasan u paraqit personalisht z. **Petrit Çela** i biri i Ymerit, lindur me 16.09.1960 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar , me cilesine ortakut te vetem dhe administratorit te vetem te shoqerise "Çela P." sh.p.k i cili me deklaroi se dokumentin e mesiperme ka redaktuar jashte kesaj zyre me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkroi ate para meje. Une noterit e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERI PUBLIK
MAJLINDA LATO



**SHOQERIA TREGTARE
ME PERGJEGJESI TE
K U F I Z U A R
" C E L A . P " Sh . P . K .
ELBASAN**

Elbasan 25 Qeshor 2005

V E N D I M

Nr.2 Dt 25.06.2005

Sot ne mbledhjen e saj te Dt 25.06.2005 une ortaku I vetem I shoqerise " C E L A P ."SH.P.K. mbasi mora ne shqyrtim raportin e ekspertit kontabel te autorizuar Z, Eduart Kila duke percaktuar strategjine per te ardhmen ,ne zbatim te kerkesave te ligjeve ne fuqi, statutit te shoqerise.

V E N D O S A

1- Te miratojme raportin e ekspertit kontabel Z. Eduart Kila lidhur me vleresimin e kapitalit te shoqerise	
2- Kapitali I shoqerise te vleresohet per	2.406.000. leke
sa raportuar nga eksperti si me poshte vijon:	
2/1 Gjendja e kapitalit me 31/12/2004	100.000 leke
2/2 Mbyllja pjesore llogarise humbje fitime te	
Viteve te kaluara	1.566.000 leke
2/3 Mbyllja e llogarise fitimi I vitit 2004	740.000 leke

Shuma pika Nr.2 2.406.000 leke

Numuri I pjeseve te kapitalit te jete per 2.406 njesi me vlere nominale per cdo njesi per leke 1.000.

Te behet depozitimi I ketij vendimi ne regjistrin Tregetar per te bere ndryshimet e nevojshme ligjore.

O R T A K U I V E T E M

PETRIT YMER CELA



PETRIT YMER CELA

RAPORT I EKSPERTIT
KONTABEL TE AUTORIZUAR
LIDHUR ME VLERSIMIN
E KAPITALIT TE SHOQERISE
MBAS VENDIMEVE TE MARRA
NE MUAJIN M A J 2005
NE RRIJTE TE TIJ

SHOQERIA TREGTARE ME
PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ C E L A . P . “SH.PK

E L B A S A N





Z . P E T R I T Y M E R C E L A

**PRONARE E
SHOQERISE TREGTARE "C E L A . P ."
SHOQERI ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR**

E L B A S A N


**SHOQERI ME KAPITAL TE PARAQITUR
NE BILANCIN E Dt .31.DHJETOR.2004
PER LEKE 100.000.**

**RAPORT I EKSPERTIT
KONTABEL TE AUTORIZUAR PER
RIVLERESIMIN NE RITJE
TE KAPITALIT NE ZBATIM
TE VENDIMIT Nr.1 TE MARRE
NGA ORTAKET
ME Dt.03. M A J . 2005.**

Ne ekzekutim te misionit tim ,qe me eshte besuar nga ana Juaj, ne zbatim te vendimit Nr-1. Dt.03.05.2005 per ndryshim ne rritje te kapitalit te shoqerise "C E L A P . " Sh.P.K. Elbasan , konkludoj si me poshte vijon ;

1- Shoqeria "C E L A . P "SH,P.K.ne bilancin e mbyllur me 31.12.2004 qe perfshin periudhen e aktivitetit ekonomik1 janar 2004 deri me 31.12.2004 dokument ky i paraqitur ne institucionet shtetere te interesuara dhe pranuar prej tyre pa verejtje, deri me Dt .31 m a j 2.005 ka nje kapital per leke 100.000,aq sa eshte vleresuar ne aktet e themelimit te shoqerise me rastin e krijimit te saj.

Kjo gjendje e paraqitur ne bilanc ne fund te vitit 2004 nuk ka ndryshim me ate te paraqitur ne celje te tij me 1.1.2004 . Gjate vitit 2004 nuk jane kryer veprime kontabel ne llogarine e kapitalit..





2- Ne postin A.-I-c-Fitime ose humbje te mbartura ,ne rastin konkret fitime te mbartura eshte paraqitur vlere e kesaj llogarie per leke 1.566.166. Ne kete llogari eshte perfshire rezultati financiar i viteve perkates dhe nuk ka vendim te marre per shperdarje te fitimit ose ndonje sistemim tjeter.

Ne vleresim te vendimit Nr.1 Dt.03.05.2005 te marre nga ana Juaj si dhe duke gjykuar per sa eshte pershkruar me siper ne zbatim te kerkesave ligjore ne fuqi , rivleresimi i kapitalit per kete post do te paraqitet :

2-1-Gjendja ne kontabilitet ose bilancin e Dt.31.12.2004 eshte e vleresuar per lerke 100.000.

2-2-Te mbyllet kjo llogari me vlere pjesore me llogarine e kapitalit ,ne rritje te tij per leke 1.566.000.

Diferenca per leke 166 te qendroje e hapur ne llogarine rezerve ligjore.Veprimi te behet per difference per mos ndryshim te numurit te plote te aksioneve per pronar.

2-3.Ne postin A – I- h Fitime dhe humbje te ushtrimit eshte paraqitur rezultati I ushtrimit te vitit 2.004 dhe rezulton me nje fitim per leke 740.178 leke .Vlera per leke 740.000 ti shtohet kapitalit te shoqerise dhe pjesa e mbetur te kaloje ne llogarine rezerva ligjore.Veprimi eshte per vleren de plote te nje aksioni dhe mos ndryshim te tij.

NE PERFUNDIM KAPITALI DO TE PARAQITET :

1- Gjendja e kapitalit te paraqitur ne bilanc me 31.12.2004 vleresohet	100.000 leke
-(regjistruar ne regjistrin tregtar 100.000)	
2-Mbyllje pjesore te postit A-I-c- fitime humbje te viteve te kaluara	1.566.000 leke
3-Ne mbyllje te postit A – I – h Fitimi I vitit ne vazhdim(2.004)	740.000 leke

Totali	2.406.000 leke

(Dymilione katerqindegjashtemije leke)

Sa siper kapitali i rivleresuar ne gjykim te bilancit te paraqitur eshte per leke 2.406,000 (Dymilione katerqindegjqshtemije leke)



O P I N I O N I

Ne konkluzion te auditimit te kryer nga ana ime shoqeria "C E L A P." Sh,P,K. Elbasan me rastin e rivleresimit te kapitalit te saj , sipas vendimit Nr.1 Dt.3 MAJ. 2.005 marre nga pronari I vetem I shoqerise Z.Petrit Ymer Cela paraqet vleren leke 2.406.000.

Ndryshimi kapitalit certifikohet nga ana ime si i bazuar ne dispozitat ligjore ne fuqi dhe ai paraqet nje vlere ne shtese per leke 2.306.000 dhe mbas ketij ndryshimi ne bilanc ay duhet te kete vleren per leke 2.406.000(Dymilione katerqindegjashtemije leke) nga 100.000 leke qe ishte me pare.

Veprimet e kryera mbeshteten ne ligjin Nr 7661 Dt.19.01.1993 " Per kontabilitetin " V.K.M.Nr 334 Dt .9.7.1993" Per miratimin e planit te pergjithshem kontabel". Ligjit Nr 7632 " Dt 4.11.1992. " Per kodin tregetar " ,ligjit Nr .7636 Dt .19.11.1992. ' Per Shoqerite Tregetare".

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR
EDUART KILA

Elbasan 2004
Lagja 5 Maj
Pallati 500/2
Tel 068 21 61 770



REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE ELBASAN
Nr. 4971 Rep

Elbasan me 01.07.2005



TAKSA E PULLES
U LIKUJDDA

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 01.07.2005 ne Elbasan ne zyren time te ndodhur prane Gjykates se Rrethit Elbasan, para meje noteres Majlinda Lato u paraqit personalisht z. **Eduart Kila** i biri i Myrtezait, lindur ne Elbasan dhe banues ne qytetin e Elbasanit, me cilesine e ekspertit kontabel te autorizuar me nr.license 49, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike , i cili dokumentin e mesiperm deklaroi se e ka hartuar vete dhe e nenshkroi me doren e tij dhe me vullnet te lire ne pranine e noteres.U vertetua dhe nga une noteria sipas ligjit.

NOTERE
MAJLINDA LATO

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA NOTEREVE ELBASAN
Nr. 4971 Rep. DT 01.07.2005
VERTETOHET QE FOTOKOPJA
ESHTE E NJEJTE ME ORIGJINALIN



NOTERJA
MAJLINDA LATO

